



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2021

**V E N D I M**

**Nr. 165, datë 13/09/2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 18, datë 18.02.2021, së z. F. Rr., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”<sup>1</sup> nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë,

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se z. F. Rr. ka qenë punonjës pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë dhe ka punuar në pozicionin e Përgjegjës të Burimeve Njerëzore pranë kësaj shoqërie. Ai është emëruar në detyrë nëpërmjet Vendimit nr. 18, datë 18.01.2019, të Drejtorit të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e punës janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës, me afat të pacaktuar, të lidhur në datën 22.04.2019.

Ankuesi pretendon se përgjatë datave 09-31.03.2020, ai ka qenë duke kryer lejen vjetore të parapambetur (të vitit 2019), e cila i është miratuar nëpërmjet Urdhërit nr. 30, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Shoqërisë. Në vijim, me shkresën nr. 452, datë 10.03.2020, të Drejtorit të Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, ankuesi është urdhëruar të ndërpresë lejen vjetore të parapambetur e të rikthehet në punë. Z. F. Rr. pretendon se shkresa nr. 452, datë

<sup>1</sup> Referuar Kartës së Anëtarësimit, të lëshuar në datën 02.07.2013, rezulton se ankuesi F. Rr. është anëtar i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim;

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

10.03.2020, nuk përmbante asnjë argumentim ligjor për ndërprerjen e lejes së tij, por pavarësisht kësaj, ai është paraqitur në punë.

Në vijim, ai sqaron se nëpërmjet Urdhërit nr. 68, datë 12.03.2020, të Drejtorit të Shoqërisë ndaj tij është dhënë masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*” me motivacionin “*moszbatimi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave*”. Më pas, me Urdhërin nr. 73, datë 01.04.2020, e Drejtorit të Shoqërisë, është dhënë masa disiplinore “*zgjdhje e menjëherëshme e marrëdhënies së punës*” me motivacionin “*moskryerje e detyrave*”. Ankuesi sqaron se edhe pse kontrata e punës i është zgjidhur në mënyrë të menjëherëshme, punëdhënësi ka nxjerrë në vijim shkresën nr. 562/1, datë 02.04.2020 me lëndë “*Njoftim për fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës*”, nëpërmjet së cilës z. F. Rr. është njoftuar për t’u paraqitur në takim në datën 06.04.2020.

Ankuesi sqaron se në të njëjtën datë, ai ka paraqitur pranë punëdhënësit ankimin administrativ nr. 575, datë 06.04.2020, ku kundërshton masat disiplinore të dhëna ndaj tij, duke kërkuar shpalljen e pavlefshmërisë absolute të akteve dhe shfuqizimin e tyre. Punëdhënësi nuk i ka kthyer asnjë përgjigje ankimit të z. F. Rr. dhe në vijim ka urdhëruar lirimin e tij nga detyra nëpërmjet Urdhërit 596, datë 08.04.2020, të Drejtorit të Shoqërisë, me motivacion “*përsëritje e shkeljeve disiplinore duke shkelur detyrimet kontraktuale me faj të rëndë*”. Sipas aktit të mësipërm, marrëdhëniet e punës përfundonin në datën 09.04.2020 dhe ato financiare përfundonin në datën 14.04.2020.

Me kërkesën nr. 601, datë 09.04.2020, ankuesi i ka kërkuar punëdhënësit akte provuese, mbi të cilat mbështetej vendimmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a. Berat-Kuçovë. Punëdhënësi i ka vënë në dispozicion z. F. Rr. vetëm procesverbalin e takimit të datës 01.04.2020, si dhe një kopje të aktit nëpërmjet së cilit është ngritur Komisioni Disiplinor.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se po diskriminohet nga Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë për shkak të bindjeve të tij politike, pasi ai është anëtar dhe aktivist i LSI. Z. F. Rr. thekson faktin se Drejtori i Shoqërisë ka dijeni mbi bindjet e tij politike, pasi ankuesi ka patur aktivitet dhe angazhim politik si në të kaluarën për subjektin politik LSI, ashtu sikurse aktualisht. Ai sqaron se në zgjedhjet e ardhshme për pushtetin qendror, që do të zhvillohen në datën 25.04.2021, subjekti politik që ai përfaqëson e ka caktuar anëtar në KZAZ nr. 66, në Berat.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga*

*Diskriminimi*<sup>3</sup>, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të bindjes politike, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërmat a), b) e c) parashikon shprehimisht se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”

---

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Hapat proçeduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 18, datë 18.02.2021, e z. F. Rr., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi proçedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë me shkresën nr. 327/1, datë 26.02.2021. Kjo shkresë iu dërgua për dijëni edhe ankuesit.

Në shkresë kërkohej informacioni vijues:

- Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
- Kopje e Vendimit të emërimit në detyrë dhe kontratave individuale të punës për z. F. Rr.;
- Kopje e librezës së punës së ankuesit;
- Praktikrat për të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj ankuesit, përfshirë këtu edhe praktikën e zgjidhjes së kontratës individuale të punës;
- Dokumentacioni që provon shkeljet e kryera nga ankuesi, të cilat kanë sjellë si pasojë dhënien e masës disiplinore dhe zgjidhjes së kontratës individuale të punës;
- Kopje të vlerësimeve në punë nga momenti i emërimit në detyrë të ankuesit;
- Ankimet e z. F. Rr. ndaj masave disiplinore dhe zgjidhjes së kontratës individuale të punës, si dhe kopje të shkresave përgjigje të Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a. Berat-Kuçovë;
- Informacion nëse çështja e zgjidhjes së kontratës së punës së ankuesit është duke u shqyrtuar gjyqësisht. Nëse po, të përcillet kërkesëpadia e z. F. Rr. dhe vendimi gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
- Lista emërore e punonjësve të Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a. Berat-Kuçovë, të cilët janë larguar nga puna nga muaji korrik 2019 e në vijim, duke specifikuar datën e emërimit të tyre, arsyen e largimit nga puna dhe pozicionin e punës që ata kanë mbajtur;

---

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Lista emërore e punonjësve të emëruar nga ish-Drejtori i Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, të cilët vazhdojnë ende të punojnë pranë këtij shoqërie. Në listë të evidentohet edhe data e emërimit në detyrë dhe pozicioni i punës;
  - Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë nuk i dërgoi përgjigje shkresës së sipërcituar të KMD-së.
  - Në vijim, Komisioneri iu drejtuar sërisht Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë me shkresën nr. 327/2, datë 02.04.2021, nëpërmjet së cilës i bën kujtesë për kthim përgjigje.
- 1. Në përgjigje të shkresave nr. 327/1, datë 26.02.2021 dhe nr. 327/2, datë 02.04.2021, të KMD-së, Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë dërgoi shkresën nr. 330/2, datë 13.04.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se ankuesi F. Rr. ka filluar marrëdhëniet e punës në Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, në datën 21.01.2019 dhe është emëruar në detyrën e Përgjegjës të Zyrës së Burimeve Njerëzore nëpërmjet Vendimit nr. 18, datë 18.01.2019, të Administratorit të shoqërisë.

Në shkresë theksohet fakti se gjatë ushtrimit të detyrës, nga ana e ankuesit ka patur raste të moszbatimit të detyrave funksionale, në lidhje me mosrespektimin e Kontratës Kolektive të Punës e parregullsi të ndryshme, të cilat parashtrihen me poshtë:

Ankuesi ka marrë masën disiplinore “*vërejtje me shkrim*” për shkak të pakujdesisë së theksuar, në ushtrimin e detyrave funksionale, ku njëra prej tyre është dhe mbikqyrja e regjimit të hyrje-daljeve të punonjësve të shoqërisë gjatë orarit zyrtar. Përgjegjësi i Zyrës së Burimeve Njerëzore ka për detyrë të kontrollojë të gjithë hyrje-daljet e punonjësve të kompanisë në ambientet e saj, duke i pasqyruar ato në regjistër të veçantë. Humbja e këtij regjistri nga pakujdesia e ankuesit (dokument që është nën kujdesin dhe mbikqyrjen e Përgjegjës të Zyrës së Burimeve Njerëzore) krijoi konfuzion në kontrollin e lëvizjeve të punonjësve të administratës dhe justifikimet e tyre përkatëse, gjatë orarit zyrtar, si dhe në llogaritjen e orëve të punës për ta, për muajin maj 2019. Konstatimi i humbjes së këtij regjistri ka ndodhur më datën 30.05.2019.

Në shkresën nr. 330/2, datë 13.04.2021, të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a., Berat-Kuçovë, sqarohet se në muajin janar 2020, me Vendimin nr. 1, datë 06.01.2020, e Këshillit të Administrimit të Ujësjetllës Berat-Kuçovë është miratuar struktura organike e kësaj shoqërie, për vitin 2020. Në pikën 2/b të këtij vendimi është miratuar mbyllja/shkurtimi i pozicionit të punës “*mirëmbajtës në sektorin Fshat Berat (Fshati Karkanjuz)*”. Ankuesi në cilësinë e Përgjegjës të Zyrës së Burimeve Njerëzore ka kryer shkelje të rëndë në zbatimin e detyrave funksionale, lidhur me zbatimin e këtij vendimi, pasi nuk ka respektuar procedurën e ndjekur për lirim nga detyra të punonjësit me detyrë mirëmbajtës, duke mos respektuar afatet respektive, sikurse parashikohet nga

dispozitat e Kodit të Punës. Si rezultat i kësaj shkeleje, shoqërisë i ka ardhur një dëm ekonomik i konsiderueshëm, pasi në procesin gjyqësor me ish-punonjësin, që ka mbajtur pozicionin e mirëmbajtësit në sektorin Fshat Berat, gjykata ka vendosur që Ujësjetllës Kanalizime sh.a. të dëmshpërblejë në shumta të konsiderueshme për dëmin e shkaktuar ndaj këtij punonjësi, si rrjedhim i mos respektimit të afateve ligjore për lirim nga detyra të tij.

Njëkohësisht, në pikën 2/a të Vendimit nr. 1, datë 06.01.2020, të Këshillit të Administrimit të Ujësjetllës Berat-Kuçovë është vendosur edhe mbyllja e pozicionit të punës specialist prokurimesh. Në zbatimin e këtij vendimi, ankuesi ka kryer shkelje të rëndë duke mos zbatuar detyrat funksionale të vendit të punës, pasi procedura për lirim nga detyra të punonjësës me emërtesë “specialist prokurimesh” ka nisur me vonesë dhe nuk është përfunduar. Ankuesi ka nisur për herë të dytë procedurën për zbatimin e vendimit të sipërcituar dhe punonjësja që mbante këtë detyrë qendroi në punë për një periudhë më të gjatë, gati 7 muaj, që nga marrja e vendimit për mbylljen e vendit të punës. Edhe në këtë rast, nga moszbatimi i ligjit apo nga zbatimi i gabuar i tij nga ana e ankuesit, kompanisë i ka ardhur dëm ekonomik, duke e trajtuar me pagesë këtë punonjëse, që duhej liruar nga detyra sipas vendimit të sipërcituar, si dhe aktualisht është në proces gjyqësor me të.

Për sa më sipër, punonjësit i është dhënë masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*” nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 68, datë 12.03.2020, të Administratorit të shoqërisë.

Në shkresë theksohet fakti se gjithashtu edhe për punonjësit G.SH. dhe S.Rr., nga ana e ankuesit nuk janë ndërmarrë procedurat e duhura për zgjidhjen e kontratës së punës sipas udhëzimeve të punëdhënësit, fakt ky që u konstatua nga vetë Administratori i shoqërisë, i cili e kapi në kohë një gabim të tillë dhe shmangu ardhjen e pasojave negative.

Në procesverbalin e datës 01.04.2020, ndër të tjera vihet re edhe moszbatim i detyrave funksionale të Përgjegjësit të Burimeve Njerëzore, që lidhen me me prezencën e punonjësve të shoqërisë, që paguhën edhe pa qenë prezent në punë, si dhe lidhur me fjalorin e përdorur nga punonjës të kompanisë ndaj Drejtoreshës Tregëtare të kompanisë, ku ankuesi në cilësinë e Përgjegjësit të Burimeve Njerëzore nuk ka ka patur asnjë iniciativë për trajtimin e tyre në bazë të Kodit të Etikës.

Ndodhur në këto kushte, kur për një periudhë 1 vjeçare, ndaj ankuesit janë konstatuar një sërë shkeljesh për moszbatim detyrash funksionale dhe parregullsish në kryejën e tyre, nëpërmjet Urdhërit nr. 73, datë 01.04.2020, të Administratorit të shoqërisë u vendos zgjidhja e menjëherëshme e kontratës së punës. Në referencë të nenit 153, pika 2, të Kodit të Punës, të gjitha rrethanat e sipërcituara kanë bërë të mundur vlerësimin e shkaqeve të justifikuar që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

Për sa më sipër, Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Berat-Kuçovë thekson faktin se rastet e procedurave, për zbatimin e strukturës së miratuar me Vendimin nr. 1, datë 06.01.2020, të Këshillit të

Administrimit të shoqërisë kanë sjellë dëm ekonomik për kompaninë dhe kjo është shkak ligjor për zgjidhjen e kontratës së punës, krahas shkeljeve të tjera të përsërituar të karakterit administrativ.

Nëpërmjet Urdhërit nr. 30, datë 31.01.2020, të Administratorit, ankuesit i është dhënë leja vjetore për periudhën 09-31.03.2020. Titullari ka nxjerrë urdhërin, pasi ankuesi pretendonte se nga momenti i daljes së aktit të sipërcituar dhe deri në datën 09.03.2020, datë, kur ai do të fillonte konsumimin e lejes, ai do t'i kishte përfunduar detyrat e tij, por që në fakt rezultoi e kundërta. Për arsyet e përmendura më lart, nëpërmjet shkresës nr. 452, datë 10.03.2020 është kërkuar ndërprejja e lejes vjetore për ankuesin pasi procedurat ishin urgjent për zbatim.

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë sqaron se shkresa nr. 562/1, datë 02.04.2020, “*Njoftim për fillimin e procedurave për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës*” drejtuar ankuesit, është hartuar në kushtet kur në shoqëri nuk kishte asnjë jurist<sup>5</sup>, ndërkohë që në Zyrën e Burimeve Njerëzore, i vetmi punonjës ka qenë z. F. Rr.. Nisur nga situata e krijuar, ankuesi ka krijuar konfuzion tek punonjësit e administratës gjatë përpilimit të kësaj shkrese, pasi me Urdhërin e Brendshëm nr. 73, datë 01.04.2020, të Administratorit është vendosur zgjidhja e menjëherëshme e marrëdhënieve të punës, në referencë të neneve 153-154 të Kodit të Punës.

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë sqaron gjithashtu se pretendimi mbi zgjidhjen e kontratës së punës për shkak të bindjes politike nuk qendron pasi sikurse u argumentua më lart, ankuesi ka kryer një seri veprimesh, të cilat kanë sjellë zgjidhjen e menjëherëshme të kontratës së tij të punës. Aktualisht, z. F. Rr. ka paditur shoqërinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës, me objekt “shpërbllim dëmi”.

Njëkohësisht, kjo shoqëri thekson faktin se në rastin e zbatimit të neneve 153-154 të Kodit të Punës, nuk kërkohet ndjekja e një procedure specifike, lidhur me njoftimin e punonjësit që lirohet nga detyra. Me Urdhërin e Brendshëm nr. 73, datë 01.04.2020, të Administratorit të Shoqërisë, ankuesi është njohur po në këtë datë. Njëkohësisht, shoqëria sqaron se shkresa nr. 582 prot., datë 06.04.2020, miratuar në vijim të shkresës nr. 562/1, datë 02.04.2020, nuk ka efekt ligjor.

Kjo shoqëri sqaron gjithashtu se në konfuzionin e krijuar rezulton se Urdhëri i Brendshëm nr. 78, datë 08.04.2020, i titullarit është i njëjtë me Urdhërin nr. 73, datë 01.04.2020. Por, në kushtet kur, në këtë të fundit rezulton një gabim material tek lënda e tij, pasi duhet të ishte theksuar përveç “*dhënies së masës disiplinore*” edhe “*zgjidhja e kontratës së punës*”. Ky fakt është shfrytëzuar nga z. F. Rr. për të konfunduar zyrtarët e kompanisë lidhur me këta dy akte.

- Në vijim të procedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 31.05.2021, pranë Zyrës së KMD-së.

---

<sup>5</sup> Në shkresë sqarohet se jurisja e shoqërisë ka qenë me leje lindjeje.



Në këtë seancë dëgjimore u paraqit ankuesi dhe përfaqësuesja e Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë. Ankuesi parashtrou edhe një hërë pretendimet e tij për diskriminim për shkak të bindjes politike, duke theksuar faktin se që prej vitit 2019 ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Burimeve Njerëzore pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë. Ai sqaroi se i është kërkuar zyrtarisht nëpërmjet shkresës nr. 452, datë 10.03.2020, të Drejtorit të Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë. Kjo shkresë nuk përcakton arsyen e ndërprerjes së lejes vjetore. Përveç sa më sipër, ankuesi vë në dukje faktin se nëpërmjet Urdhërit nr. 68, datë 12.03.2020, të Drejtorit të Shoqërisë ndaj tij është dhënë masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*” me motivacionin “*moszbatimi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave*”. Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 73, datë 01.04.2020, e Drejtorit të Shoqërisë, është dhënë masa disiplinore “*zgjidhje e menjëherëshme e marrëdhënies së punës*” me motivacionin “*moskryerje e detyrave*”, duke zgjidhur në mënyrë të menjëherëshme kontratën e punës. Z. F. Rr. sqaron gjithashtu se edhe pse i ishte zgjidhur kontrata e punës, Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, i dërgoi shkresën nr. 562/1, datë 02.04.2020 me lëndë “*Njoftim për fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës*”, nëpërmjet së cilës z. F. Rr. është njoftuar për t’u paraqitur në takim në datën 06.04.2020. Sipas ankuesit procedurat e ndjekura nga punëdhënësi nuk kishin kuptim nga ana ligjore.

Në të njëjtën datë, z. F. Rr. ka depozituar pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, ankim administrativ, nëpërmjet shkresës së tij nr. 575, datë 06.04.2020, nëpërmjet së cilës kundërshton masat disiplinore të dhëna ndaj tij, duke kërkuar shpalljen e pavlefshmërisë absolute të akteve dhe shfuqizimin e tyre. Punëdhënësi nuk i ka kthyer asnjë përgjigje ankimit të z. F. Rr. dhe në vijim ka urdhëruar lirim të tij nga detyra nëpërmjet Urdhërit 596, datë 08.04.2020, të Drejtorit të Shoqërisë, me motivacion “*përsëritje e shkeljeve disiplinore duke shkelur detyrimet kontraktuale me faj të rëndë*”.

Ai u shpreh se të gjitha veprimet e sipërcituara janë kryer kundër tij për shkak se është anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe ka aktivitet politik në këtë subjekt politik. Ai u shpreh se zëvendësuesja e tij, në pozicionin e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, e cila është përfaqësuese e punëdhënësit në këtë seancë dëgjimore, është anëtare e Këshillit Bashkiak dhe anëtare e forcës politike në pushtet.

Përfaqësuesja e Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë e kundërshtoi ankuesin duke sqaruar se është anëtare në forcën politike “Bindja Demokratike”, si dhe theksoi faktin se largimi i ankuesit nga puna nuk kishte të bënte me bindjet e tij politike. Ajo sqaroi se ankuesi ka kryer disa shkelje për të cilat i ishin dhënë masa disiplinore, deri në largim nga puna. Shkeljet e tij kanë qenë të tilla, sa i kanë shkaktuar shoqërisë dëm ekonomik. Konstatimi i shkeljeve ishte kryer nga vete Administratori i shoqërisë. Ajo theksoi faktin se në kushtet kur juristja e institucionit ishte me leje lindje dhe ankuesi ishte Drejtor i Burimeve Njerëzore kishte kryer krijuar konfuzion në shkresat e dala nga shoqëria, lidhur me procedurat që ishin ndjekur për largimin e tij nga puna. E pyetur mbi



faktin se përse punëdhënësi nuk i kishte kthyer përgjigje ankimit administrativ të ankuesit lidhur me masat disiplinore të dhëna ndaj tij, ajo u shpreh se lidhur me këtë çështje do të dërgonte informacion me shkrim. Ajo theksoi faktin se ankuesi nuk është paraqitur në takimin e lënë nga punëdhënësi, ndërkohë që ankuesi theksoi faktin se ai ka qenë prezent në punë por ky takim nuk është zhvilluar ndonjëherë. Ai sqaroi se ka kërkuar kopje të listëprezencës në punë për të vërtetuar prezencën e tij në punë, si dhe hapjen e kamerave të sigurisë për të vërtetuar këtë fakt, por punëdhënësi nuk e ka kryer një gjë të tillë. Përfaqësuesit e KMD-së i kërkuan përfaqësueses së Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a. Berat-Kuçovë të dërgonte në vijim të seancës dëgjimore informacionin e mëposhtëm: Kopje të praktikave mbi masat disiplinore të dhëna ndaj ankuesit, listëprezencën e muajit prill 2020, Procesverbalin e takimit të mbajtur nga komisioni disiplinor, ku konstatohet mungesa e z. F. Rr., observacionet e z. F. Rr., informacion mbi shpalljen e pavlefshmërisë së disa prej akteve lidhur me largimin nga puna etj. Informacioni i kërkuar u mbajt shënim nga përfaqësuesja e shoqërisë e cila ra dakord për dërgimin e tij, në vijim të seancës dëgjimore.

- Në vijim të seancës dëgjimore, Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat, Kuçovë dërgoi shkresën nr. 330/5, datë 09.06.2021, nëpërmjet së cilës përcolli pranë KMD-së, disa akte të kërkuara gjatë seancës dëgjimore.
- Në kushtet kur, Komisioneri vlerësoi se informacioni i dërguar nuk ishte i plotë, iu drejtuar kësaj shoqërie nëpërmjet e-mailit zyrtar, ku i kujton se ka barrën e provës gjatë shqyrtimit administrativ të kësaj çështjeje, si dhe i kërkoj informacionin e mëposhtëm:
  - Kopje të praktikave mbi masat disiplinore të dhëna ndaj ankuesit (akti i njoftimit, procesverbali i takimit, observacionet e ankuesit) ;
  - Aktet administrative që provojnë shkeljet e kryera nga ankuesi për dhënien e masës disiplinore dhe largimin nga puna;
  - Listëprezencën e muajit prill 2020;
  - Në kushtet kur, rezultojnë dy akte për largimin nga puna të z. F. Rr. dhe UK sh.a., Berat - Kuçovë ka sqaruar se ankuesi është larguar në mënyrë të menjëherëshme nga puna, të jepet informacion, nëse për aktin tjetër është shpallur pavlefshmëria e tij;
  - Informacion nëse ka punonjës të tjerë pranë Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a. Berat-Kuçovë, të cilët sikurse ankuesi janë të anëtarësuar pranë LSI (sikurse edhe në subjekte të tjera politike, opozitare), por që ende vazhdojnë të punojnë pranë kësaj shoqërie. Nëse po, të dërgohen emrat e tyre dhe mundësisht prova që vërtetojnë anëtarësinë e tyre në këtë subjekt politik.
- Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë dërgoi në përgjigje e-mailit të KMD-së, e-mailin e datës 09.08.2021, nëpërmjet së cilit u dërgua informacioni përkatës.

- Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesi F. Rr. dërgoi në adresë të KMD-së, shkresën nr. 327/5, datë 11.06.2021, nëpërmjet së cilës parashtron informacion lidhur me shkeljen e procedurave ligjore të parashikuar në Kodin e Punës, nga ana e Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, për sa i përket ndërprerjes së marrëdhënies së tij të punës.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.**

Referuar dokumentacionit të depozituar në cilësi prove pranë Komisionerit, rezulton se z. F. Rr. është emëruar në detyrën e Përgjegjës të Zyrës së Burimeve Njerëzore pranë Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, nëpërmjet Vendimit nr. 18, datë 18.01.2019, të Drejtorit të kësaj shoqërie, z. P.S. Marrëdhëniet e punës ndërmjet palëve janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës, me afat të pacaktuar, të lidhur në datën 22.04.2019.

Nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 195, datë 31.05.2019, të Drejtorit të Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a. Berat-Kuçovë, *“Për dhënie mase disiplinore “Vërejtje me shkrim” përgjegjës të Zyrës së Burimeve Njerëzore, z. F. Rr.”*, ankuesit i është dhënë masa disiplinore vërejtje me shkrim. Në pikën 1 të këtij Urdhëri citohet: *“Dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim: për Përgjegjës të Zyrës së Burimeve Njerëzore z. F. Rr., pasi në zbatim të detyrave të caktuara në Rregulloren e brendshme të Shoqërisë në lidhje me disiplinën në punë (mbajtjen e regjistrit të hyrje-daljeve të punonjësve të administratës) nuk e ka kryer detyrën e ngarkuar me kujdesin e duhur, pasi ky regjistër në datën 30.05.2019, ora 8:00 u konstatua i humbur”*. Sipas pikës 2 të Urdhërit, ngarkohet Përgjegjësi i Zyrës së Burimeve Njerëzore z. F. Rr. që në vazhdimësi të çelë një regjistër të ri të hyrje daljeve të punonjësve të administratës, i cili të jetë në mbikqyrje të plotë gjatë gjithë orarit zyrtar 08:00 – 16:00. Në pikën 3, të Urdhërit përcaktohet se vërejtja me shkrim hyn në fuqi në datën 31.05.2019 dhe pas afatit 6 mujor punonjësi do të rikthehet në gjendjen e mëparshme sikur kjo masë të mos ishte dhënë asnjëherë.

Për sa më sipër, administrimi i këtij regjistri bën pjesë në detyrat e Përgjegjës të Burimeve Njerëzore të kësaj shoqërie. Kontakimi i humbjes së regjistrit të hyrjeve dhe daljeve të punonjësve është bërë nga vetë z. F. Rr., i cili ka kryer konstatimin nëpërmjet Procesverbalit të datës

30.05.2019<sup>6</sup>, si dhe e ka informuar Administratorin e Shoqërisë, z. P.S. mbi këtë fakt, nëpërmjet shkresës nr. 912, datë 30.05.2019, mbi këtë fakt.

Nëpërmjet Urdhërit nr. 2018, datë 10.06.2019, të Drejtorit të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a. Berat-Kuçovë “Për firmosjen e listëprezencës nga punonjësit” rezulton se duke filluar nga data 10.06.2019, libri i listëprezencës do të mbahet nga sekretarja e Arshiv-Protokollit. Në këtë urdhër përcaktohet edhe detyrimi i Përgjegjësit të Burimeve Njerëzore që të dërgojë informacion me shkrim, çdo ditë, tek Administratori i shoqërisë, lidhur me punonjësit që nënshkruajnë listëprezencën.

Nga dokumentacioni i administruar në cilësi prove rezulton se ankuesi nuk e ka ankimuar masën e dhënë nga punëdhënësi, masë e cila aktualisht është shuar.

Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 30, datë 31.01.2020, të Administratorit të shoqërisë, z. F. Rr. i është dhënë leja vjetore nga data 09.03.2020 deri në datën 31.03.2020. Në vijim të këtij Urdhëri, nëpërmjet shkresës nr. 452 prot., datë 10.03.2020, z. F. Rr. urdhërohet të ndërpresë lejen vjetore. Për sa më sipër, rezulton se shkresa në fjalë nuk e përmban shkakun e ndërprerjes së lejes vjetore.

Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 68, datë 12.03.2020, të Drejtorit të Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë, ndaj z. F. Rr. është marrë masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*” me motivacionin për “*moszbatim të dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave*” duke mos respektuar afatet e njoftimit të përcaktuara sipas nenit 143 të Kodit të Punës. Lidhur me dhënien e kësaj mase disiplinore, Komisioneri konstaton se punëdhënësi nuk ka zbatuar procedurat përkatëse, sipas nenit 37, paragrafi 2, i Kodit të Punës, ku citohet: “... *Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm.*” Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë nuk ka depozituar në cilësi prove asnjë akt që të vërtetojë se nga ana e tij janë ndjekur procedurat përkatëse.

Justifikimi i shoqërisë për dhënien e kësaj mase konsiston në shkeljet e z. F. Rr., në lidhje me zbatimin e përcaktimeve të Vendimit nr. 1, datë 06.01.2020, e Këshillit të Administrimit të Ujësjetllës Berat-Kuçovë, akt ky që ka kryer ndryshime në strukturën organike të kësaj shoqërie, për vitin 2020. Në pikën 2/b të këtij vendimi është miratuar mbyllja/shkurtimi i pozicionit të punës “*mirëmbajtës në sektorin Fshat Berat (Fshati Karkanjuz)*”. Sipas shoqërisë, ankuesi në cilësinë e Përgjegjësit të Zyrës së Burimeve Njerëzore ka kryer shkelje të rëndë në zbatimin e detyrave funksionale, lidhur me zbatimin e këtij vendimi, pasi nuk ka respektuar procedurën e ndjekur për lirim nga detyra të punonjësit me detyrë mirëmbajtës, duke mos respektuar afatet respektive, sikurse parashikohet nga dispozitat e Kodit të Punës. Si rezultat i kësaj shkeljeje, shoqërisë i ka ardhur një dëm ekonomik i konsiderueshëm, pasi në procesin gjyqësor me ish-punonjësin, që ka

<sup>6</sup> Procesverbal i datës 30.05.2019, është nënshkruar nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore, z. F. Rr., Roja i Ndërmarrjes, z. V.H. dhe Shoferi i Ndërmarrjes, z. Xh.K.

mbajtur pozicionin e mirëmbajtësit në sektorin Fshat Berat, gjykata ka vendosur që Ujësjiellës Kanalizime sh.a. të dëmshpërblejë në shuma të konsiderueshme për dëmin e shkaktuar ndaj këtij punonjësi, si rrjedhim i mos respektimit të afateve ligjore për lirim nga detyra të tij.

Njëkohësisht, Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat- Kuçovë ka sqaruar se në pikën 2/a të Vendimit nr. 1, datë 06.01.2020, të Këshillit të Administrimit të Ujësjiellësit Berat-Kuçovë është vendosur edhe mbyllja e pozicionit të punës specialist prokurimesh. Në zbatimin e këtij vendimi, ankuesi ka kryer shkelje të rëndë duke mos zbatuar detyrat funksionale të vendit të punës, pasi procedura për lirim nga detyra të punonjëses me emërtesë “*specialist prokurimesh*” ka nisur me vonesë dhe nuk është përfunduar. Ankuesi ka nisur për herë të dytë procedurën për zbatimin e vendimit të sipërcituar dhe punonjësja që mbante këtë detyrë qendroi në punë për një periudhë më të gjatë, gati 7 muaj, që nga marrja e vendimit për mbylljen e vendit të punës. Edhe në këtë rast, nga moszbatimi i ligjit apo nga zbatimi i gabuar i tij nga ana e ankuesit, kompanisë i ka ardhur dëm ekonomik, duke e trajtuar me pagesë këtë punonjëse, që duhej liruar nga detyra sipas vendimit të sipërcituar, si dhe aktualisht është në proces gjyqësor me të. Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat- Kuçovë ka depozituar në cilësi prove aktet, nëpërmjet së cilave është kryer liri nga detyra i punonjësve të sipërcituar dhe faqen e parë të Vendimit nr. 1, datë 06.01.2020, të Këshillit të Administrimit të Ujësjiellësit Berat-Kuçovë.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se pavarësisht sqarimeve të subjektit dhe akteve të depozituara në cilësi prove nga ana e tij, nuk ekziston asnjë akt shkresor, ku shkeljet në fjalë të rezultojnë të materializuara apo dokumentuara. Komisioneri vlerëson gjithashtu se moszbatimi i procedurave për dhënien e masës disiplinore të sipërcituar, ka bërë të pamundur që ankuesi të paraqesë observacionet dhe shpjegimet e tij për të sqaruar situatën në tërësi dhe për t’u mbrojtur para punëdhënësit.

Në vijim të masës disiplinore, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 73, datë 01.04.2020, të Drejtorit të Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, z. F. Rr. i është dhënë masa vijuese disiplinore “*Zgjidhje e menjëherëshme e marrëdhënies së punës*” me motivacion “*moskryerje e detyrave*” me rastet e përsëritjes së shkeljes. Masa e sipërcituar mbështetet në konstatimet e kryera në mbledhjen e datës 01.04.2020. Referuar procesverbalit të kësaj mbledhjeje, ku pjesëmarrës kanë qenë z. P.S.- administrator i shoqërisë, znj. E.M., z. F. Rr., z. F.M., znj. M. L. dhe znj. M. Gj rezulton se ankuesit i vihet në dukje fakti që pavarësisht faktit, që punonjës të caktuar nuk janë paraqitur në punë dhe nuk kanë nënshkruar në regjistrin e listëprezencave, ai i ka shënuar në bordero, sikur kanë qenë në punë, ndërkohë që porosia e Administratorit ka qenë e ndryshme. Njëkohësisht, znj. E.M., drejtore e një tjetër drejtorie pranë kësaj shoqërie ka shprehur shqetësimin e saj, pasi është cënuar me fjalë jo etike nga punonjësit e drejtorisë që ajo drejton, duke nënkuptuar që z. F. Rr. në cilësinë e Përgjegjës të Burimeve Njerëzore duhet të merrte masa ndaj tyre. Për sa më sipër, Komisioneri konstatoi se procesverbali i sipërpërmendur është i nënshkruar vetëm nga sekretarja e Arkivë-Protokollit, por jo nga pjesëmarrësit në mbledhje. Njëkohësisht, ky procesverbal nuk është i regjistruar dhe nuk mban numër protokolli. Në këtë kontekst, KMD

vlerëson se ky procesverbal nuk mund të konsiderohet si provë e vlefshme, mbi bazën e se cilës mund të vërtetohen shkeljet e kryera nga ankuesi.

Në vijim të sa më sipër, procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës të ankuesit, ka rifilluar duke i dërguar atij shkresën nr. 562/1, datë 02.04.2020 me lëndë *“Njoftim për fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës”*, nëpërmjet së cilës z. F. Rr. është njoftuar për t’u paraqitur në takim në datën 06.04.2020.

Në të njëjtën datë, z. F. Rr. ka depozituar pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, ankim administrativ, nëpërmjet shkresës së tij nr. 575, datë 06.04.2020, nëpërmjet së cilës kundërshton masat disiplinore të dhëna ndaj tij, duke kërkuar shpalljen e pavlefshmërisë absolute të akteve dhe shfuqizimin e tyre. Punëdhënësi nuk i ka kthyer asnjë përgjigje ankimit të z. F. Rr. dhe në vijim ka urdhëruar lirimimin e tij nga detyra nëpërmjet Urdhërit 596, datë 08.04.2020, të Drejtorit të Shoqërisë, me motivacion *“përsëritje e shkeljeve disiplinore duke shkelur detyrimet kontraktuale me faj të rëndë”*.

Lidhur me fillimin e procedurës së dytë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, punëdhënësi ka sqaruar se aktet e sipërcituara nuk janë të vlefshme dhe nuk kanë fuqi ligjore, pasi ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesin është kryer paraprakisht nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 73, datë 01.04.2020, të Drejtorit të Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, mbi të cilin ankuesi ka marrë njoftim. Sipas shoqërisë, një gjë e tillë ka ndodhur pasi nuk ka patur persona kompetentë, të cilët mund të merreshin me këto procedura, pasi juristja e shoqërisë ka qenë me leje lindjeje.

Në prapësimet e tij, ankuesi ka depozituar në cilësi prove aktin Vendim Emërimi nr. 75, datë 06.04.2020, të Administratorit të Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat- Kuçovë, ku rezulton se z. G.D. është emëruar jurist i komanduar pranë kësaj shoqërie deri në paraqitjen në punë të juristes, që është me leje lindjeje. Për sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar se aktet nëpërmjet së cilave ka filluar procedura e dytë për lirimimin nga detyra të ankuesit janë miratuar para komandimit të juristit G.D. Pavarësisht këtij fakti, KMD çmon se kjo shoqëri duhet të shpallte pavlefshmërinë e akteve në fjalë, në referim të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Mbështetur në sa më sipër, KMD gjykon se ankuesi F. Rr. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë.

## **B. Shkaku i mbrojtur “bindja politike”.**

Z. F. Rr. pretendon diskriminim për shkak të *“bindjes politike”*, nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë.

*“Bindja politike”* është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të *“bindjes politike”*, Komisioneri gjykon se *“bindja politike”* konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Ankuesi ka depozituar gjithashtu në cilësi prove kopje të Kartës së Anëtarësimit, të datës 02.07.2013, lëshuar nga LSI, ku rezulton se z. F. Rr. është anëtar i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – bindja politike.**

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se z. F. Rr. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore, që i garantohet individit lidhur me shkakun e bindjes politike, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombehtar.

Për sa më sipër, parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit parashikohet nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga akte të tjera ligjore, duke sanksionuar njëkohësisht edhe zbatimin e tij nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Referuar nenit 49, të Kushtetutës së Republikës parashikohet: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Në këtë sens, kjo dispozitë i garanton çdo individ të drejtën për punë. Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohet barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, sikurse edhe në Kartën Social Europiane (të rishikuar) dhe shtojcën e saj përkatësisht në nenin 24, pika 3, gërma d) parashikohet shprehimisht: *“...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e*



*punësimi....d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare përgjegjësitë familjare, shtatëzania, besimi fetar, opinion politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”.*

Referuar vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë<sup>7</sup>, për çështjen *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2012), duke u mbështetur në parimin e tij të nenit 11, të KEDNJ-së, që partitë politike janë thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë, Gjykata konsideron: *“Duke pasur parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventave, Gjykata konsideron se në mungesë të masave mbrojtëse gjyqësore një sistem juridik i cili lejon largimin nga puna vetëm për shkak të anëtarësimit të punonjësve në një parti politike mbart me vete mundësinë e abuzimit”* (paragrafi 55).

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: *“a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”*.

Në nenin 12, pika 1, gërmat b) dhe (c), të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, parashikohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;”*

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Neni 9, pikat 9 & 10, të Kodit të Punës parashikojnë shprehimisht: *“9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 10. Në të gjitha procedurat*

---

<sup>7</sup> Redfearn v The United Kingdom: ECHR 6 Nov 2012;

*e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë.”*

Kodi i Procedurës Administrative<sup>8</sup>, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Ujësllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., e cila duhet të provojnë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

LMD, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Ujësllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., që duhet të provojë se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues për shkak të bindjes së tij politike.

Kështu, neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, përcakton se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”*

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjisllacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS<sup>9</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjisllacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.**

---

<sup>8</sup> Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

<sup>9</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>10</sup>

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi, dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht<sup>11</sup>”.*

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të ankuesit, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e Ujësullës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, pasi ndaj ankuesit nuk janë zbatuar procedurat përkatëse nga ana e punëdhënësit për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim”, si dhe zgjidhja e menjëherëshme të kontratës së punës nuk është kryer mbi shkelje konkrete të ankuesit, të cilat duhet të ishin të dokumentuara nga ana e shoqërisë në akte ligjorisht të vlefshme.

Përsa i përket bindjeve politike të ankuesit, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe specifikisht referuar Kartës së Anëtarësimit, të lëshuar në datën 02.07.2013, rezulton se ankuesi F. Rr. është anëtar i subjektit

<sup>10</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

<sup>11</sup> GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

politik Lëvizja Socialiste për Integrim. Njëkohësisht, referuar Vërtetimit të datës 01.02.2021, të lëshuar nga subjekti politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” rezulton se ankuesi është anëtar i kësaj forcë politike me numër anëtarësie 49639 dhe ka marrë pjesë aktivisht në veprimtaritë në shkallë kombëtare të organizuara nga kjo parti. Ai është aktivizuar publikisht nëpërmjet pjesëmarrjes në mitingje elektorale, takime politike në ambiente të hapura dhe salla të mbyllura, ka kryer anketime dhe publikime të programit të LSI, si dhe shpërndarjen e materialeve publikuese në terren. Në vërtetimin e sipërcituar sqarohet se: *“Në zgjedhjet e përgjithshme, si dhe në zgjedhjet për pushtetin vendor anëtar i LSI, F. Rr., është angazhuar maksimalisht për rritjen e popullaritetit dhe besueshmërisë së kësaj force politike në publik. Gjithashtu anëtar i LSI, F.Rr ka marrë pjesë me cilësinë e vëzhguesit, komisionerit, numëruesit në Komisionet zgjedhore në territorin e Qarkut Berat, si vëzhgues i caktuar nga forca politike LSI, Gjithashtu anëtar i LSI, F. Rr. është anëtar i KZAZ nr. 66 për zgjedhjet e pushtetit qendror në datën 25.04.2021”*.

Njëkohësisht, Komisioneri sjell në vëmendje faktin se Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. është një shoqëri aksionere, e cila funksionon në bazë dispozitive të ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*, i ndryshuar. Referuar ekstraktit të Regjistrimit Tregtar mbi të dhënat e kësaj shoqërie, të administruar nga Qendra Kombëtare të Regjistrimit rezulton se, aksionerë të kësaj shoqërie janë, Bashkia Berat me 65.32 % të aksioneve dhe Bashkia Kuçovë me 34.68 % të aksioneve.

Në këtë kontekst rezulton se aksioneri kryesor i Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. është Bashkia Berat, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. E. D. Ndërkohë që, rezulton se, edhe aksioneri tjetër i kësaj shoqërie, Bashkia Kuçovë, përfaqësohet nga Kryetari i Bashkisë, z. K. H., i cili është zgjedhur në këtë funksion në qershor 2019, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie nga Partia Socialiste e Shqipërisë, në kuadër të koalicionit Aleanca për Shqipërinë.<sup>12</sup> Në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”*, i ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, është organi më i lartë vendimarrës i Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë. Nga analiza e sipërcituar, rezulton se Asambleja e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., e përbërë nga Bashkia Berat dhe Bashkia Kuçovë, përfaqësohet nga përfaqësues të subjektit politik, Partia Socialiste.

Në prapësimet e tij, Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. nuk e ka kundërshtuar ndonjëherë faktin se nuk ka dijeni mbi bindjet politike të ankuesit, por thekson faktin se shkak për largimin e tij të menjëhershëm nga puna nuk ka qenë bindja e tij politike, por shkeljet e kryera nga ana e tij. Kjo shoqëri ka vënë në dijeni të KMD-së se ka punonjës të tjerë të saj, të që kanë anëtarësi në subjekte të ndryshme politike, opozitare me Partinë Socialiste, të cilët

---

<sup>12</sup> Referuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve [www.cec.gov.al](http://www.cec.gov.al),

ende punojnë në të. Në këtë kontekst, rezulton se znj. Dh.P., aktualisht me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Financës, pranë Ujësllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë, ka qenë Nënkrjetare e Këshillit Bashkiak, pas zgjedhjeve të vitit 2015<sup>13</sup>, në Bashkinë Berat, si përfaqësuese e subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”. Ujësllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. sqaron se kjo punonjëse pavarësisht bindjes politike dhe anëtarësisë së saj në subjektin LSI punon pranë kësaj shoqërie. Njëkohësisht, z. F.M., aktualisht me detyrë specialist finance, sikurse punonjësja e sipërcituar, ka qenë Anëtar Këshilli në Bashkinë Berat, përfaqësues i Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), përgjatë periudhës 2015-2019. Njëkohësisht, znj. B.K., aktualisht me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Burimeve Njerëzore është anëtare e Këshillit Bashkiak si përfaqësuese e Partisë Bindja Demokratike. Ujësllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. ka depozituar në cilësi prove listëprezencën e muajit korrik 2021, ku vërteton se individët e sipërcituar janë punonjës të kësaj shoqërie, si dhe aktin “*Lista emërore e anëtarëve të Këshillit Bashkiak në Berat pas zgjedhjeve vendore të datës 21 qershor 2015*”.

Pavarësisht fakteve të sipërcituara, KMD gjykon se nuk disponon informacion të mjaftueshëm mbi faktin nëse punonjësit në fjalë ndodhen në pozita të njëjta apo të ngjashme me ankuesin F. Rr. dhe se në mbajtjen e tyre në punë nuk ka patur ndikim të rrethanave të tjera, që këta punonjës janë ende në punë, ndërkohë që z. F. Rr. është larguar nga puna. Komisioneri gjykon se prezenca në punë e punonjësve të tjerë që kanë bindje dhe anëtarësi opozitare me titullarët e subjektit politik në pushtet nuk përbën fakt bindës se largimi nga puna i z. F. Rr. nuk është bërë për shkak të bindjeve politike ose se largimi i tij është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

Në këtë kontekst, Komisioneri vë në dukje faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Ujësllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., fakt që është analizuar edhe më sipër. Kështu, nëpërmjet Urdhërit nr. 68, datë 12.03.2020, të Drejtorit të Ujësllës Kanalizime Berat-Kuçovë, ndaj z. F. Rr. është marrë masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*” me motivacionin për “*moszbatim të dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave*” duke mos respektuar afatet e njoftimit të përcaktuara sipas nenit 143 të Kodit të Punës. Lidhur me dhënien e kësaj mase disiplinore, Komisioneri ka konstatuar se punëdhënësi nuk ka zbatuar procedurat përkatëse, sipas nenit 37, paragrafi 2, i Kodit të Punës<sup>14</sup>, Ujësllës Kanalizime Berat-Kuçovë nuk ka depozituar në cilësi prove asnjë akt që të vërtetojë se nga ana e tij janë ndjekur procedurat përkatëse. Komisioneri konstatoi gjithashtu se nuk ekziston asnjë akt shkresor, ku shkeljet në fjalë të rezultojnë të materializuara apo dokumentuara. Komisioneri vlerëson gjithashtu se moszbatimi i procedurave për dhënien e masës disiplinore të sipërcituar, ka bërë të

<sup>13</sup> Përgjatë periudhës kohore 2015-2019;

<sup>14</sup> Ku përcaktohet: “... *Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm.*”

pamundur që ankuesi të paraqesë observacionet dhe shpjegimet e tij për të sqaruar situatën në tërësi dhe për t'u mbrojtur para punëdhënësit.

Në vijim të masës disiplinore, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 73, datë 01.04.2020, të Drejtorit të Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., z. F. Rr. i është dhënë masa vijuese disiplinore *“Zgjidhje e menjëherëshme e marrëdhënies së punës”* me motivacion *“moskryerje e detyrave”* me rastet e përsëritjes së shkeljes. Komisioneri konstatoi se procesverbali i mbledhjes, i cili është akti mbi të cilin është mbështetur largimi nga puna, është i nënshkruar vetëm nga sekretarja e Arkivë-Protokollit, por jo nga pjesëmarrësit në mbledhje. Njëkohësisht, ky procesverbal nuk është i regjistruar dhe nuk mban numër protokollit. KMD vlerësoi se ky procesverbal nuk mund të konsiderohet si provë e vlefshme, mbi bazën e se cilës mund të vërtetohen shkeljet e kryera nga ankuesi.

Në vijim, Ujësjiellës Kanalizime Berat- Kuçovë sh.a. ka nisur sërish procedurat e largimit nga puna për z. F. Rr., pavarësisht akteve të mëparshme për largim të menjëhershëm nga puna që kishte nxjerrë paraprakisht për ankuesin. Aktualisht rezulton se kjo shoqëri nuk ka shpallur pavlefshmërinë e akteve të nxjerra si rrjedhojë e fillimit të këtyre procedurave për herë të dytë dhe për punonjësin rezultojnë dy procedura për largimin e tij nga puna.

Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e garantuar nga Kodi i Punës, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr.10221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime mbi çdo punëdhënës që krijon, ndryshon apo i jep fund marrëdhënies së punës, të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastin konkret bindjet politike përbëjnë shkak diskriminues për përfundimin e marrëdhënies së punës, sa kohë që punëdhënësi Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë ka dështuar të japë shpjegime alternative e të besueshme se largimi nga puna i ankuesit është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se z. F. Rr. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të bindjes politike, nga ana e Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë.

Përveç sa më sipër, ankuesi F. Rr. ka kërkuar nga Komisioneri edhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, largimi prej së cilit është kryer në kushtet e diskriminimit për bindjet politike.

Në nenin 33, pika 10, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”*, ndërsa mbështetur në nenin 33, pika 12, të po këtij



ligji, përcaktohet se: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.*

Në nenin 33, pika 10, të LMD, të ndryshuar nuk janë përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës diskriminuese, atribut ky që është lënë në diskrecionin e Komisionerit. Në këtë kontekst, Komisioneri vendos rast pas rasti, se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të individëve që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit.

Përveç sa më sipër, në nenin 9/9, të Kodit të Punës Parashikohet shprehimisht se në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Ligji i posaçëm që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi, është Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar. Në nenin 38 të LMD, të ndryshuar, i cili jep përkufizimin e dëmshpërblimit, që jepet nga gjykata kompetente në rastet e konstatimit të diskriminimit, parashikohet shprehimisht se: *“Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e dukur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme.”*

Nëpërmjet këtij parashikimi ligjor, në rastet kur konstatohet se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur si pasojë e diskriminimit, një nga mënyrat e dëmshpërblimit është rikthimi i punonjësit në gjendjen e mëparshme. Komisioneri çmon se, rikthimi në gjendjen e mëparshme realizohet duke e rivendosur marrëdhënien e punësimit të ndërprerë për shkak të diskriminimit. Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese ndaj ankuesit konsiston pikërisht në përfundimin e marrëdhënies së punës dhe largimin e saj nga puna. Si rrjedhim, edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit.

Komisioneri vlerëson se masa e dukur për rregullimin e situatës diskriminuese, të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të ankuesit, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e sistemuar ankuesin në një pozicion pune të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur më parë prej tij. Komisioneri çmon se sistemimi i ankuesit në punë, është një masë rregulluese, e cila është në përpjesëtim me gjendjen që ka shkaktuar vendosjen e kësaj mase.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga LMD, i ndryshuar, nuk do të ishte efektive nëse punëdhënësi nuk detyrohet të rivendosë marrëdhënien e punësimit.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenit 12, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të z. F. Rr., për shkak të bindjes politike, nga Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë.
2. Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. të marrë masa për sistemimin e ankuesit në një pozicion pune të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur më parë prej tij.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijëni për këtë vendim, Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij Vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijëni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Fusha – Punësim  
Shkak – bindja politike  
Lloji i vendimit - diskriminim